



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Lezhë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*Data 28/07/2022*

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K & “I.C.C GROUP” SH.P.K, perfaqesuar nga Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, me adrese Strum, fshati Suke i siperm, Nr. 2, Rruga Strum-Suke, Km-3, Lagjia Zoga, Roskovec, Fier.

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur/ Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-33849-06-22-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Permiresimi i infrastruktures rrugore per kembesoret dhe biçikletat ne fshatin Ishull Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 Muaj nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “2 N” SH.P.K, me Nuis L31615017L dhe me oferte ekonomike 16,926,636 (gjashtembedhete milion e nenteqind e njezet e gjashte mije e gjashteqind e tridhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis J63229466K & “I.C.C GROUP” SH.P.K, me Nuis L51308006A dhe me oferte ekonomike 19,816,834 (nentembedhete milion e teteqind e gjashtembedhete mije e teteqind e tridhjetë e kater) Lek pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “ASI-2A” SH.P.K me Nuis K5300240C dhe me oferte ekonomike 20,084,246 (njezet milion e tetedhjetë e kater mije e dyqind e dyzet e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 4- Operatori Ekonomik “DELIA GROUP” SH.P.K, me Nuis J81517002U dhe me oferte ekonomike 20,151,709.52 (njezet milion e njeqind e pesedhjetë e nje mije e shtateqind e nente pike pesedhjetë e dy) Lek pa TVSH.

- 5- Operatori Ekonomik “K.TURJA” SH.P.K, me Nuis K81314014A dhe me oferte ekonomike 18,080,878.4 (tetemdhjetë milion e tetëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e tete pike kater) Lek pa TVSH.
- 6- Operatori Ekonomik “LEON KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K71820009I dhe me oferte ekonomike 18,109,956 (tetemdhjetë milion e njëqind e nente mijë e nentëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 7- Operatori Ekonomik “SARDO” SH.P.K, me Nuis K13120402W dhe me oferte ekonomike 20,123,476 (njëzet milion e njëqind e njëzet e tre mijë e katerqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 8- Operatori Ekonomik “SHKELQIMI 07” SH.P.K, me nuis K68121808W dhe me oferte ekonomike 12,700,000 (dymbëdhjetë milion e shtatëqind mijë) Lek pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

### **I-Operatori Ekonomik “2 N” SH.P.K, me Nuis L31615017L.**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.5, ku parashikohet se *“Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te jene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Teknik Ndertimi	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Teknik Elektrik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Hekurkthyes	1 (nje)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale
- Shofer	1 (nje)	Leje Drejtimi
- Manovrator	1 (nje)	Çertifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

*Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmitë profesionale/ Leje Drejtimi/ Çertifikate e Aftesise Profesionale (CAP), sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2022 - Maj 2022.*

*Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.*

KVO verën se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin*

permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit e mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka te deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, disponimin e 1 (nje) hekurkthyesi, i cili eshte kerkuar ne piken 2.3.5, te kritereve te vecanta te kualifikimit duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji", vendosi te refuzoje oferten e OE "2 N" SH.P.K, per mos permbushje te kritereve te vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", OE "2 N" SH.P.K, me Nuis L31615017L, skualifikohet.**

## **II- Operatori Ekonomik "ASI-2A" SH.P.K me Nuis K5300240C.**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3,

KVO bazuar ne nenin 83, te ligjit nr.162/ 2020 "Per prokurimin publik", parashikohet se: *1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

---

*Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.*

Si dhe në nenin 30, të VKM-së 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së. Enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, mund të kërkojë ose jo sigurim oferte për procedurat nën kufirin e lartë monetar. 2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës së vlerës së sigurimit, nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, sigurimi i ofertës mund të ketë formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë veprimtari”*,

Sa me sipër KVO, vlereson se për të përmbushur këto kriter OE-te duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e cila duhet të jetë e neshkuar nga Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezultoi se OE nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertes sipas shtojcës 3, duke e bërë të pa përmbushur këto kriter.

**Se dyti**, nuk plotëson kriterin 2.3.8, ku parashikohet se *“Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi, qira ose kontrate bashkëpunimi impiantet si më poshtë vijon:*

- a. 1 (një) Impiant prodhimi Inerte*
- b. 1 (një) Impiant prodhimi Betoni*
- c. 1 (një) Impiant prodhimi Asfalti*

*Për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit, në rast se është në pronësi duhet të paraqiten dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë. Në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/ bashkëpunimit.*

*(KVO do të verifikojë nëpërmjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit është i pajisur me license III.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet)”*.

KVO vëren se për plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin për impiantin e prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit, në rast se është në pronësi, dokumente që vërtetojnë pronësinë e saj, (Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë, ndërsa në rast se impianti i prodhimit të inerteve/ betonit/ asfaltit është me qera ose kontrate bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e qerave/ bashkëpunimit.

---

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues ne lidhje me disponimin ne pronesi/ me qira/ kontrate bashkepunimi per impiant prodhimi inertesh, betoni dhe asfalti duke mos permbushur kete kriter.

**Se treti**, nuk ploteson kriterin 2.3.9, ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*Per Materialet Elektrike:*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

KVO veren se per plotesimin e ketij kriteri operoret ekonomike duhet te paraqesin per materialet elektrike, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues ne lidhje me furnizimin me materialet elektrike duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriteve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “ASI-2A” SH.P.K, per mos permbushje te kriteve te vecanta kualifikuese.

---

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “ASI-2A” SH.P.K me Nuis K5300240C, skualifikohet.**

### **III- Operatori Ekonomik “DELIA GROUP” SH.P.K, me Nuis J81517002U.**

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se OE

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 2.3.9, ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*Per Materialet Elektrike:*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

KVO verën se për plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për materialet elektrike, kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues ne lidhje me furnizimin me materialet elektrike duke mos permbushur kete kriter.

**Se dyti**, Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.10, ku parashikohet se *“Operatorët Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:*

- ISO 9001:2015, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj*
- OHSAS 18001:2015, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, ose ekuivalentin e saj*
- ISO 14001:2015, mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalentin e saj.*

KVO verën se për plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin Çertifikatat e vlefshme sipas standarteve ISO të leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike ka paraqitur Çertifikatën OHSAS 18001:2015, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, e cila ka skaduar me datën 17.04.2022, duke mos permbushur kete kriter.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore

---

përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “DELIA GROUP” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

**Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “DELIA GROUP” SH.P.K, me Nuis J81517002U, skualifikohet.**

#### **IV- Operatori Ekonomik “K.TURJA” SH.P.K, me Nuis K81314014A.**

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se OE:

**Se pari**, nuk ploteson kriterin 1, në lidhje me Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit dhe 2.1.1, të kushteve të vecanta të kualifikimit në të cilin përcaktohet se ky kriter plotësohet “2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit (Shtojcat)”.

Kvo, verën se në shtojcën 7, parashikohet si më poshtë:

##### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

*Ofertuesi deklaron se:*

*a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*

*c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*

---

*ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*

*d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*

*dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*

*e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*

*gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

*h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*

*i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

Gjithashtu KVO, verën se bazuar në pikën 1 dhe 2(c), të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parshikohet se:

*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,*

*2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*, për të përmbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka plotësuar për administratorin **ALBAN TURJA**, i cili sipas QKB-se është emëruar administrator me datën 21.12.2021, të dhenat në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në seksionin

---



ne lidhje me informacionin dhe deklarimin ne zbatim te pikes 2(c), te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, ne te cilen duhet te deklarohet si me poshte:

**“ç) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”;**

Per kete KVO, sjell ne reference edhe Vendimin e KPP nr. 537/2019, date 14.08.2019, ne te cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues ne kete vendim pikerisht, sepse nuk ka plotesuar e deklaruar te gjithë emrat sipas formatit te shtojces 8 te DST.

Konkretisht, KPP ne kete vendim shprehet:... **“KPP gjykon se në rastin konkret nuk jemi ne kushtet e devijimit të vogël apo pamundësisë së autoritetit kontraktor për të verifikuar se kush është ortaku i shoqërisë, por jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese”.** *Formati i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve të përmëndur më sipër në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca e dorëzuar nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar”.*

Sa me lart duke qene se formati i shtojcës 8, e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendim marrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca nr. 8, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke qene se ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit nuk eshte deklaruar nje nga administratoret e OE.

**Se dyti**, nuk ploteson kriterin 2.3.9, te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrat e furnizimit per materialet si me poshte:*

*Per Materialet Elektrike:*

*- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.*

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike ne rast se nuk jane prodhues duhet te paraqesin per materialet elektrike kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me

---

distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar

Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur kontratë furnizimi me një subjekt (furnizues i cili nuk rezulton të jetë prodhues), por nuk ka paraqitur autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen e këtij subjekti me ndonjë prodhues.

KVO duke pasur në konsideratë se të gjithë prodhuesit e kanë detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, bëri një kerkim në faqen zyrtare [qkb.gov.al](http://qkb.gov.al), ku rezultoi se furnizuesi për materialet elektrike nuk disponon QKL si prodhues.

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga OE, nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis Furnizuesit (si distributori zyrtar) me ndonjë prodhues, ky kriter konsiderohet i papërbushur.

